





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TE 7
Berat Buzhala
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2021/318- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
TE 7 (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, me anë të të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë Udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
2. Me datën 18 tetor 2021 Komisioni i KPM-së mori Vendim që Pala përgjegjëse të sanksionohet në shumën prej dy mijë (2,000) euro për shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës dhe Rregullores KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale për Zgjedhjet Lokale 2021 për shkeljet e gjetura gjatë Zgjedhjeve Lokale 2021.
3. Me datën 1 nëntor 2021 KPM i ka dërguar Palës përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073. Qëllimi i dërgimit të udhëzuesit ka qenë që të licencuarve t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore për balotazh.
4. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhjet si dhe Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së ka bërë monitorimin e këtij subjekti gjatë fushatës zgjedhore të balotazhit. Bazuar në Raportin e monitorimit të datës 10 nëntor 2021 KPM ka gjetur emisionet "Pressing" dhe "DPT", të transmetuara me datën 8 dhe 9 nëntor 2021, kanë qenë të sponsorizuara si dhe kanë përmbajtur reklamim me ekran të ndarë, edhe përkundër faktit se në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe nenit 14 paragrafi 3, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, reklamimi më ekran të ndarë dhe sponsorizimi nuk janë të lejuara në programet e çështjeve aktuale. Gjithashtu, në emisionet "Pressing" dhe "DPT" ka pasur vendosje të produkteve, edhe përkundër faktit se në bazë të nenit 15, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07, vendosja e produkteve nuk është e lejuar në programet e çështjeve aktuale, duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale.

5. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 10 nëntor 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe e ka udhëzuar që menjëherë të veprojnë në pajtueshmëri me Rregulloren e KPM-2017/07, duke mos transmetuar përmbajtje të tilla komerciale në emisionet e çështjeve aktuale.
6. KPM, për të vlerësuar ardhjen në pajtueshmëri të Palës përgjegjëse me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073, si dhe Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së në mënyrë të vazhdueshme ka bërë monitorimin e këtij ofruesit të shërbimeve mediale. Bazuar në Raportin e monitorimit të datës 11 nëntor 2021, KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse edhe me datën 10 nëntor 2021 ka vazhduar t'i përsërisë shkeljet e njëjta sa i përket Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1, nenin 14 paragrafi 3 dhe nenin 15. Po ashtu, në datën 10 nëntor 2021 KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar hapësirë reklamuese politike të subjektit politik PDK, e cila është identifikuar si hapësirë e sponsorizuar, mirëpo nuk është treguar organizata apo individë përgjegjës që e ka sponsorizuar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Analiza ligjore

7. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në analizat dhe faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1, nenin 14 paragrafi 3 dhe nenin 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale dhe me nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
8. KPM, ka vlerësuar se edhe pse Pala përgjegjëse është njoftuar me kohë për respektim të Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhje, Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, i është dërguar Udhëzuesi me qëllim që t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore, sërish është gjetur në shkelje. Bazuar në Raportet e monitorimit është gjetur se Pala përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për balotazh në emisionet "Pressing" dhe "DPT", të transmetuara te Pala përgjegjëse me datën 8, 9 dhe 10 nëntor 2021, kanë pasur reklamim me ekran të ndarë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, i cili përcakton se::

"Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t'ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë."

9. KPM, po ashtu ka gjetur emisionet "Pressing" dhe "DPT", të transmetuara te Pala përgjegjëse me datën 8, 9 dhe 10 nëntor 2021, të cilat trajtojnë çështje aktuale politike, sociale, ekonomike dhe zhvillimet e fundit në vend, janë sponsorizuar, duke vepruar kështu

në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, i cili përcakton se:

“Programet e lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale nuk do të sponsorizohen.”

10. KPM, ka gjetur se Pala përgjegjëse në emisionet “Pressing” dhe “DPT” ka bërë edhe vendosje të produkteve, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 15, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale

11. KPM duke u bazuar në Raportin e monitorimit të datës 11 nëntor 2021, po ashtu ka gjetur se Pala përgjegjëse me datën 10 nëntor 2021 ka transmetuar hapësirë reklamuese politike të subjektit politik PDK, e cila është identifikuar si hapësirë e sponsorizuar, mirëpo nuk është treguar organizata apo individ përgjegjës që e ka sponsorizuar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili përcakton se:

“Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të”.

12. Komisioni si rrethanë rënduese për Palën përgjegjëse e konsideron dështimin e këtij subjekti për të vepruar në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 03/L-073 dhe aktet nënligjore edhe në të kaluarën, konkretisht në Zgjedhjet Lokale të vitit 2021.

13. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 12 paragrafi 1, nenin 14 paragrafi 3 dhe nenin 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, dhe nenin 49 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.


Vendim


14. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumën prej katër mijë (4,000) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 12 paragrafi 1, nenin 14, paragrafi 3 dhe nenin 15 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale, dhe nenit 49 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

E drejta për ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.

16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat Latifi
Kryetar



11/11/2024
Datë